



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Florije Rexhepi</b>	<b>24.03.2026</b>	<b>02.04.2026</b>	<b>2026/0168</b>

### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 19.03.2026, OE “Beni Dona Plast SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0168, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sherbimet me Ushqim (Furnizim, Pergatitje dhe Servim) per nevojat e PK-se” me nr. të prokurimit: "214/30400-25-8322-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 2,700,000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

## **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:**

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;  
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;  
Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit;

**Shkeljet e dispozitave - Rregullores 02/2024 për Prokurimin Publik (RRPP 002/2024), janë:**

Neni 40 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;  
Neni 43- Ndërprerja e procedurave të prokurimit;  
Neni 97 – Shkeljet e Renda , paragrafi (h)- Mos respektimi i vendimit të OSHP-së Nr. OSHP/2025/1248 të datës 09.02.2026

## **KRITERET PËR VLERËSIM**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Beni Dona Plast SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet me Ushqim (Furnizim, Përgatitje dhe Servim) për nevojat e PK-se” me numër të prokurimit: “214/30400-25-8322-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	<b>Përshtatshmëria profesionale:</b>	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
		<b>Kërkesa 1- Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik- Çertifikata Regjistrimit të Biznesit (nëse OE i jashtëm shpallet fitues duhet te regjistroj përfaqësinë ne Kosovë para nënshkrimit te kontratës).</b>	<b>Dëshmia 1- Kopja e certifikatës të numrit unik</b>
		<b>Kërkesa 2- Certifikatë e TVSH-se (për Operoret Ekonomik vendor).</b>	<b>Dëshmia 2- Certifikatën e TVSH-së (kopje) (për Operoret Ekonomik vendor).</b>
		<b>Kërkesa 3. Certifikata ISO 9001 2015 ( sistemi i menaxhimit të cilësisë ) - duhet të jetë valide.</b>	<b>Dëshmia 3 - kopje e Çertifikatës ISO 9001 2015 ( sistemi i menaxhimit te cilësisë ) - duhet të jetë valide dhe të lëshuar nga një kompani e akredituar.</b>
		<b>Kërkesa 4. Çertifikata ISO 22000 2018 ( sistemi i menaxhimit të siguriisë ushqimore ) - duhet të jetë valide dhe të lëshuar nga një kompani e akredituar.</b>	<b>Dëshmia 4 Kopja e Certifikatës ISO 22000 2018 ( sistemi i menaxhimit të siguriisë ushqimore ) - duhet të jetë valide dhe e lëshuar nga një kompani e akredituar.</b>
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	<b>Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</b>	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
		<b>Kërkesa 1- • Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK-së , se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë</b>	<b>Deshmi 1. OE duhet te dëshmojë me deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në</b>

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Beni Dona Plast SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet me Ushqim (Furnizim, Përgatitje dhe Servim) për nevojat e PK-se” me numër të prokurimit: “214/30400-25-8322-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	<b>Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</b>  <b>Kërkesa 1- Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK-së , se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë</b>	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>  <b>Dëshmi 1. OE duhet të dëshmojë me deldaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në</b>
		<b>tre viteve të fundit ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 2,500,000.00 € (ne rast te grupit min. 51% te plotësohet nga lideri).</b>	<b>Administratën Tatimore të Kosovës apo ne vendin e themelimit për tri vitet e fundit.</b>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<b>Kapaciteti teknik dhe profesional:</b>  <b>Kërkesa 1 - Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjtë apo të ngjashme (shërbim të gastronomisë ) gjatë 3 (tri) viteve të fundit ( nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) jo më pak se 2,000,000.00 €. Lideri duhet të mbuloj së paku 51% të referencave të vlerës së kontratave të realizuara në vlerën e kërkuar.</b>	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i>  <b>Dëshmia 1. Operatori Ekonomik duhet të ofroj listën e kontratave të natyrës së njëjtë në fushën e gastronomisë me referenca pozitive të përfunduara në vlerë min. 2,000,000.00 € duke ju bashkangjitur listës së kontratave. Lista e kontratave e nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik. Në rast <del>konzerciumi</del> lideri duhet ti ketë në emër të OE referencat me vlerë 51% të totalit për vitet e fundit të dëshmuara me referenca të suksesshme të përfunduara, në kopje në rast <del>konzerciumi</del>, të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritetet përkatëse , për shërbimet e pranuar , të cilat duhet të tregojnë numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës , datën e nënshkrimit të kontratës , natyrën dhe vendin e realizimit. a. Kur shërbimi është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet të dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca të jetë e cekur vlera e shërbimeve) të lëshuara nga autoriteti i tillë. b. Kur shërbimi është bërë për një blerës privat, duhet të dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca (në referenca duhet të jetë e cekur vlera e shërbimeve) të lëshuara nga blerësi i tillë. Vërejtje - Asnjë kontratë nuk do të llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e shërbimeve ose raportet e pranimeve të shërbimeve të cilat duhet të dëshmohen me transaksione bankare.</b>
		<b>Kërkesa 2. Operator Ekonomik duhet të dëshmoj minimumin e kapacitetin e fuqisë punëtore të kompanisë me të dhënat në vijim emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani minimum 20 punëtor.</b>	<b>Dëshmia 2. OE duhet të ofroj dëshmi listën e punëtorëve të kompanisë e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Në listë duhet të ceken dhënat në vijim; emri, mbiemri, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani.</b>
		<b>Kërkesa 3. OE duhet të dëshmoj stafin Professional min. 4 kuzhinierë të kualifikuar në fushën e gastronomisë si dhe min. 1 ( një)</b>	<b>Dëshmia 3. Listën e stafit profesional vulosur dhe nënshkruar nga OE, duke ofruar dëshmi - Diplomë ose certifikatë për secilin kuzhinier CV, kopja e kontratave të punës ose para</b>

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Beni Dona Plast SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet me Ushqim (Furnizim, Përgatitje dhe Servim) për nevojat e PK-se” me numër të prokurimit: “214/30400-25-8322-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

		<p><b>kualifikimi i teknologut të ushqimit duhet të jetë min. Bachelor.</b></p> <p><b>Kërkesa 4. OE duhet të ofroj dëshmi për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicionin për realizimin e këtij tenderi si në vijim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Automjet i mbyllur frigorifer min. 1 copë.</b></li> <li>• <b>Automjet i mbyllur për transport ushqimi min. 3 copë.</b></li> <li>• <b>Pajisjet e nevojshme për ruajtje dhe transport të ushqimit në teren (termoset) minimum 10 copë.</b></li> <li>• <b>OE duhet të ketë një restorant për ofrim të shërbimeve me min. 60 ulëse në territorin e Prishtinës.</b></li> </ul>	<p><b>Ndërsa për Teknolog të dëshmohet kopja e diplomës, CV, kopja e kontratave të punës ose para kontrata me emër të projektit në fjalë.</b></p> <p><b>Dëshmia 4. Lista e mjeteve dhe pajisjeve teknike të cilat janë kërkuar duhet të dorëzohet, i nënshkruar dhe i vulosur nga OE ose marrëveshje mbi marrjen me qira të pajisjeve në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.</b></p> <p><b>Dëshmitë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Libreza e regjistrimit të automjeteve me validitet si dhe fotografit- kopje.</b></li> <li>• <b>Fotografitë me përshkrim të pajisjeve për bartjen e ushqimit- kopje.</b></li> <li>• <b>OE duhet të ketë një restorant në pronësi të vet ose marrëveshje me qira në afat prej 36 muajsh.</b></li> </ul>
--	--	--	---

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Beni Dona Plast SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet me Ushqim (Furnizim, Përgatitje dhe Servim) për nevojat e PK-se” me numër të prokurimit: “214/30400-25-8322-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

	<b>Republika e Kosovës</b> Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrašnjih Poslova Ministry of Internal Affairs	
	<b>Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police</b> Drejtoria e Përgjithshme e Policisë / Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate	

**B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES<sup>1</sup>**

*Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik*

**Titulli i kontratës: SHËRBIMET ME USHQIM (FURNIZIM, PËRGATITJE DHE SERVIM) PËR NEVOJAT E PK-SE RIVLERESIM**

Nr. i prokurimit <sup>2</sup>	214/30400-25-8322-2-1-1
Nr i brendshëm	214-25-106-2-1-1

Nr.	Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave
1.	Beni Dona Plast SH.P.K. Ulpiana Tregu i Gjellbërt, PRISHTINË 810545981	65.97 €
2.	ISUF MUSLIU B.I. 810692691	68.13 €

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

**Policia e Kosovës anulon aktivitetin e prokurimit në mungesë të një oferte të përgjegjshme**

Data:

27/02/2016

Emri dhe mbiemri i ZPP:



<sup>1</sup> Ketij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde të njoftimeve: B42, B45 dhe B46.( shtoni letra njoftuese sipas nevojës).

<sup>2</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

**B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

#### VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

#### VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi OSHP: 2025/0984

Vendimi OSHP: 2025/1248

#### ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

#### PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - Beni Dona Plast SH.P.K.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me Vendimin (B58) të AK – Policia e Kosovës, ka parashtruar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 dhe 62 të LPP-se.

Autoriteti kontraktues, pas rivlerësimit të ofertave, me datën 27.02.2026 e njofton OE ankues me letrën standarde te tenderuesit të eliminuar.

OE ankues eliminohet me arsyetimin si me poshtë:

OE është i papërgjegjshëm për pikat ne vijim:

OE ka ofruar çmime te cilat janë me te larta nga çmimet reale te tregut.

- Komisioni i rivlerësimit ka kërkuar te behet hulumtimi i tregut dhe nga hulumtimi i tregut pas vendimit te OSHP rezulton se OE ka ofertuar me çmime shumë herë me te larta se sa ato real ne treg, ndaj duke ju referuar nenit 4.1 pikës C të rregullore nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik e cila thotë gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim: sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut ju keni ofruar me çmime shumë herë me te lart se sa çmimet reale te tregut, duke ju referuar ofertës financiare OE ka ofruar me çmime shumë here me te larta për te gjithë artikujt se sa vlera reale e tregut dhe te planifikuara nga ana e AK.

- Duke ju referuar edhe interpretimit te KRPP AK ne harmoni te plot me LPP ka kërkuar sqarime gjate fazës se pare te vlerësimit mbi çmimet shumë herë me te larta se sa ato reale ne treg dhe OE ka ofruar vetëm një zbërthim por asnjë dëshmi apo dokumentim se si ka arritur deri tek formulim i këtyre çmimeve.

Interpretimi nga KRPP si më poshtë:

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron:

Sa i përket çështjes së ofrimit të çmimeve me të larta se çmimet reale të tregut, KRPP sqaron se kjo çështje nuk rregullohet me ndonjë dispozite të veçantë në ligj dhe legjislacion dytësor të prokurimit publik siç është i rregulluar ofrimi i çmimit jo-normalisht të ulët, megjithatë KRPP në analogji me rregullat për tenderët jo-normalisht të ulët (B57), gjegjësisht neni 41.6 i Rregullores për Prokurim Publik i cili përcakton se trajtimi i tenderit si jo-normalisht i ulët nuk konsiston vetëm në total, por edhe në pozicione si dhe duke u bazuar në nenin 87 të LPP-së (i cili ndër të tjera e autorizon KRPP-në që të jap Opinione Autoriteteve Kontraktuese dhe Operatoreve Ekonomik për veprimet e tyre), andaj KRPP konsideron se, ofrimi i çmimeve me të larta se çmimet reale të tregut nuk konsiston vetëm në total por edhe në pozicione.

Sikurse edhe për çmim jo-normalisht të ulët, ashtu edhe për çmim me të lartë, AK njëjtë do ta ndjek procedurën e përcaktuar me nenin 61 të LPP-së, që do të thotë nuk mund të refuzoi automatikisht ofertën me çmim të lartë qoftë edhe për pozicion pa kërkuar një sqarim me shkrim nga OE.

Paragrafi i lartë cituar, thjeshtë kërkon nga Autoriteti Kontraktues që gjatë administrimit të procedurave të prokurimit të sigurohet që çmimi i kontraktuar të mos jetë më i lartë se çmimi i tregut.

### **Pretendimi nr. 1**

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-Policia e Kosovës, e eliminon OE ankues me të njëjtin arsyetim, çështje e cila është trajtuar në raportin paraprak të ekspertizës dhe për të njëjtin paneli shqyrtues ka nxjerr vendimin me Nr. OSHP: 2025/1248 të datës 09/02/2026.

Eksperti shqyrtues, sqaron se përgjigja lidhur me këtë pretendim është dhënë në raportin e ekspertizës Nr. 1248/25, për të cilën vlerësoj se është e drejte e autoritetit kontraktues.

Po ashtu eksperti shqyrtues, sqaron se AK- pas pranimit të vendimit të panelit shqyrtues, e ka formuar komisionin për rivlerësimin e ofertave të cilët kanë hulumtuar çmimet e tregut. Te gjitha shkresat e lendes lidhur me rivlerësimin e ofertave dhe hulumtimin e çmimeve nga ana e komisionit rivlerësues janë të bashkangjitura në raportin e rivlerësimit të AK të publikuar në platformën e E-Prokurimit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues në ankesën e tij përsëri jep prova e veta të cilat i konsideron si valide dhe se çmimet nuk janë me të larta se çmimet e tregut.

Në fund eksperti shqyrtues, siç e ka vlerësuar edhe në raportin paraprak sqaron se vlerësimi i çmimeve është e drejte e autoriteti kontraktues, bazuar në paragrafin 4 të Nenit 61 të LPP-se.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Beni Dona Plast SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Shërbimet me Ushqim (Furnizim, Përgatitje dhe Servim) për nevojat e PK-se**” me numër të prokurimit: “**214/30400-25-8322-2-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Beni Dona Plast SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Shërbimet me Ushqim (Furnizim, Përgatitje dhe Servim) për nevojat e PK-se**” me numër të prokurimit: “**214/30400-25-8322-2-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Beni Dona Plast SH.P.K.**

